DEÇANI

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT / MUNICIPALITY OF DECAN / OPŠTINA DEČANI

**Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër**
**02.nr. Zyrtarisht/19.**
**Deçan, 10.01.2019**

**Për:** **Kryetarin e Komunës së Deçanit**
**Z. Bashkim Ramosaj**

**Nga :** **Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Deçan**
***Z.* Agron Muslijaj**

**Lënda:** **Plan Pune për vitin 2019, i Drejtorisë**

**Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe planin e punës për vitin 2019 për Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit në Deçan.**

DALESE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT • OPŠTINA DEČANE • DECAN MUNICIPALITY
Njesia-Org. / Org. Jedinica / Org. Unit: DRJ. Gjeodezi
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 1154
Nr. i faqeve: 02
Data / Datum / Date: 11.01.19


Sheshi " Mentor TOLAJ " p.n.

Tel & Fax : 0390 / 361 360

## *P L A N   P U N E*

## *Për periudhën Janar – Dhjetor 2019 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Deçan*

**1. Shefi i Sherbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referenten e ndryshimeve kadastrale**

Meqenëse Drejtoria jonë Kryesisht punon në bazë të kërkesave të palëve , nuk kemi mundësi reale që të caktojmë volumin e punëve për vitin 2019, por ne duke u bazuar në statistikat që i mbajnë mendojmë se në këtë vit do të ketë trend të rritjes së volumit të punëve , krahasuar me vitet paraprake.

Në vazhdim në bazë të punëve të kryera në vitet e kaluar dhe bazuar në trendin e rritjes së kërkesave të palëve po japin një pasqyrë e cila do na shërbejë si orientim i synimeve të kryerjes së punëve brenda vitit raportues dhe atë për secilin vend pune.

Zyrtari për RDPP – njëkohësish Shefi i Drejtorisë për Kadastër dhe Zyrtarja e Ndërrimeve kadastrale planifikojnë që në këtë vit të shqyrtoi përafërsisht **460**, kërkesa të palëve të cilat kanë të bëjnë me ndërrimin e pronarëve dhe futjen e të dhënave të reja në sistemin e SIKTK- es.

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit kryen edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronësoro dhe së bashku me Referenten për ndryshime kadastrale kryejnë edhe punë tjera me urdhër të drejtorit dhe sipas nevojës .

## 2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit

Këta zyrtar gjatë periudhës 01.01.2019 deri 31.012.2019 mendojmë se do kryejnë afro **300** raste tereni sipas kërkese së palëve për të cilat do bëjnë azhurimin adekuat nëpër librat kadastral dhe më pas do i dërgojnë te Juristi për marrje te vendimeve adekuate .

Punët ne teren do i kryejnë Kompanitë dhe Gjeodetët e Licencuar për shkak se ne nuk posedojmë instrument GPS për dalje në teren.

Gjithashtu këta zyrtar mendojmë se do kryejnë me tepër se 50 raste të lëshuarjes së Historiateve si dhe do dalin në teren sipas nevojave dhe kërkesave zyrtare të Komunës.

Të njëjtit do kryej edhe detyra tjera sipas nevojave të cilat paraqiten në këtë shërbim siç janë konsultat me palë dhe punë tjera në zyre.

## 3. Referenti për pranimin e palëve

Gjatë kësaj periudhe , referenti për pranimin e palëve mendojmë se do pranojë përafërsisht **3500** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e Komunës etj..

I njëjti zyrtar i procedon të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët pajisen me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës.

Ky plan i punës nuk parasheh 100% punët që do kryhen gjatë vitit 2019 por siç u tha edhe më larë është plan orientues i cili është përpiluar duke u bazuar në statistikat e punëve të kryera nga vitet paraprake i që shihet se për secilin vit ka tendenca të rritjes volumit të punës.

**Raportin e hartoi :**
**Shefi i kësaj Drejtorie**
**Hasan Hulaj**

**Planin e Aprovoi :**
**D r e j t o r i**
**Agron Muslijaj**